



GLOBAL
YOUNG
ACADEMY

Punuar me
16/11/2023
Allea
All European
Academies
Miratuar

KARTA THEMELORE E AKADEMISË SË TË RINJVE TË SHQIPËRISË¹

Preambul

Nisma për themelimin e *akademive të të rinjve* filloi në mbarë Botën në vitin 2000, me ngritjen e së parës akademi të të rinjve në Gjermani, mbështetur në marrëveshjen midis Akademisë së Shkencave të Sakta e Humane *Berlin-Brandenburg* dhe Akademisë Gjermane të Shkencave të Natyrës *Leopoldina*. Ndërmjet viteve 2005-2017 u krijuan mbi 40 akademi të të rinjve në mbarë Botën dhe u themelua *Akademia Botërore e të Rinjve (Global Young Academy)*, në të cilën u pranuan shumica e tyre, duke u përfshirë në mënyrë aktive në aktivitetet e saj. Akademi të të rinjve që veprojnë pranë ose brenda akademive të shkencave anëtare të ALLEA-s janë krijuar në Shqipëri, Austri, Belgjikë, Danimarkë, Estoni, Gjermani, Finlandë, Holandë, Norvegji, Poloni, Skoci e Suedi. Akademitë e të rinjve bashkojnë studiues të talentuar premtues, që kanë arritur rezultate cilësore shkencore dhe dëshirojnë t'i promovojnë këto rezultate.

1. Organizimi

Akademia e të Rinjve është organizëm që funksionon pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në bazë të nenit 20 të Ligjit 53/2019, me autonomi veprimi e drejtimi të rregulluar në kuadër të kësaj *karte themelore*; e cila pas miratimit shërben si Statut i saj, me emrin zyrtar *Akademia e të Rinjve e Shqipërisë*.

¹ Karta e Akademisë së të Rinjve të Lituanisë është miratuar me Rezolutën nr. 1 datë 24 shtator 2018 të mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve të Akademisë së Shkencave të Lituanisë. Karta është rishikuar për herë të fundit me Rezolutën nr. 3, datë 17 prill 2019.

✓

Karta themelore e veprimtarisë së *Akademisë së të Rinjve* miratohet nga Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Simbolet dhe statuti për funksionimin e brendshëm të *Akademisë së të Rinjve* hartohen e propozohen prej saj dhe miratohen nga kryesia e ASHSH, në pajtim me Ligjin nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë.

2. Qëllimi

Akademia e të Rinjve bashkon studiues të rinj aktivë nga të gjitha fushat, qëllimet dhe veprimtaria e të cilëve përputhen me misionin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Anëtarët e *Akademisë së të Rinjve* zgjidhen nga radhët e kërkuesve që kanë arritur rezultate shkencore cilësore premtuese dhe janë të gatshëm për t'u angazhuar në nisma e aktivitete shkencore e novatore të përbashkëta.

Akademia e të Rinjve është përfaqësim i nivelit të cilësisë së kërkimit në brezat e rinj. Ajo shqipton dhe mbron interesat e kërkuesve të rinj të vendit; është zëdhënëse e tyre pranë Akademisë së Shkencave; jep mendime për çështje të politikave shkencore që ndiqen në vend; ndërmerr nisma shkencore që kërkojnë sinergji në kërkim brenda dhe ndërmjet brezave; nxit synimet e kushtet për karrierë akademike-universitare; ndërvepron me akademitë e të rinjve në vende të tjera për të rritur qarkullimin e njohurive të arritura në kërkim; për të shqyrtuar me ekspertizë gjendjen dhe rezultatet e tyre në mjedise akademike; si dhe për të aktivizuar mentorimin akademik.

3. Anëtarësimi

Anëtarët e *Akademisë së të Rinjve* zgjidhen me procedurë konkurruese të hapur. Kriteret e konkurrimit hartohen dhe miratohen nga Kryesia e Akademisë së Shkencave. Kandidatët duhet të kenë arritur rezultate të rëndësishme kërkimore të vlerësuara nga borde e komisione shkencore; të jenë aktivë në veprimtarinë profesionale dhe shoqërore; të kenë mbrojtur gradën *doktor i shkencave* jo më herët se dhjetë vjet më parë dhe si rregull të jenë nën 36 vjeç, përjashtimisht nën 38 vjeç, në datën përfundimtare të pranimit të dokumenteve për konkurrim.

Në vitin e themelimit zgjidhen fillimisht deri në 12 anëtarë dhe çdo vit në vijim zgjidhen 3-5 anëtarë të rinj, varësisht prej vendeve të lira. Numri i përgjithshëm i anëtarëve në çdo rast nuk mund të kalojë mbi 20. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit të *Akademisë së të Rinjve* është si

rregull jo më shumë se 4 vjet, përjashtimisht deri 7 vjet. Në çdo rast mandati mbaron kur kandidati mbush moshën 40 vjet. Në mbarim të mandatit anëtarët e *Akademisë së të Rinjve* konsiderohen *alumni* të saj.

4. Zgjedhjet

Me shpalljen e konkursit për anëtarësim në *Akademinë e të Rinjve*, kandidatët që plotësojnë kushtet e përcaktuara si më sipër u drejtohen për vlerësim me shkrim e rekomandim sipas rastit: senateve akademikë dhe/apo këshillave shkencorë të institucioneve kërkimore dhe të arsimit të lartë; jo më pak se tre anëtarëve të *Akademisë së Shkencave të fushës* dhe shoqatave shkencore të vendit.

Dokumente të domosdoshme për t'iu paraqitur bashkë me kërkesën Kryesisë së *Akademisë së Shkencave* janë: CV, bibliografi dhe listë botimesh; listë veprimtarish të tjera kërkimore të tyre; përshkrim aplikacionesh, patentash, projektesh kërkimore dhe aktiviteteve inovative të realizuar prej tyre, si dhe çdo dokument tjetër në funksion të certifikimit të plotësimin të kushte të konkursit.

Për zgjedhjen e fituesve krijohet një komision që ka në përbërje: anëtarë të *Akademisë së Shkencave* (sipas fushave të kërkimit) dhe, në rast të nevojshëm, ekspertë të jashtëm. Përbërja e komisionit miratohet nga Kryesia e *Akademisë së Shkencave*. Fituesit e konkursit shpallen *anëtarë të Akademisë së të Rinjve* sipas vendimit të komisionit. Anëtari i *Akademisë së të Rinjve* gëzon të drejtën e certifikatës së anëtarësisë në një formë të njësuar. Në mbledhjen e tyre të parë anëtarët e *Akademisë së të Rinjve* zgjedhin për një mandat dyvjeçar kryetarin, sekretarin e kryesinë e punës.

5. Mundësimi i veprimtarisë

Me synimin për përfaqësimin e interesave të brezit të ri të studiuesve, *Akademia e Shkencave e Shqipërisë* ofron këto kushte për zhvillimin suksesshëm të veprimtarisë së *Akademisë së të Rinjve*:

- Sigurimin pa pagesë të mjediseve për zhvillimin e konferencave shkencore, seminareve, tryezave të debatit, si dhe për ngjarje të tjera shkencore;
- Mundësi logjistike dhe për mjedise për veprimtarinë e të zgjedhurve (kryetar, sekretar, kryesi);
- Mbështetje brenda mundësive ekzistuese me pajisje dhe logjistikë të domosdoshme për punët administrative të drejtuesve të saj;

- Financimin e përdalluar të veprimtarive shkencore të të rinjve, në formën e projekteve, nismave kërkimore, bazuar mbi konkurrencën;
- Pjesëmarrjen vepruese në veprimtaritë shkencore të Akademisë së Shkencave; përfaqësimin e tyre më vete ose bashkë me njësi e struktura të saj me jo më pak se dy veprimtari në vit të programet e përvitshme;
- Botimin e një reviste shkencore *online* me periodicitet dy herë në vit;
- Përrurimin e veprimtarisë së të rinjve, anëtarë e bashkëpunëtorë të saj, në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave dhe në rrjetet sociale të saj, përmes një rubrike ose ndërfaqje (interface) të veçantë;
- Mundësimin e pjesëmarrjes në konferenca shkencore jashtë vendit dhe përfaqësimin në organizatat ndërkombëtare të shkencëtarëve të rinj si ALLEA dhe *Global Young Academy*;
- Kryetari i Akademisë së të Rinjve merr pjesë si i ftuar në mbledhjet e Kryesisë e në ato të Asamblesë kur diskutohet për çështje që lidhen me politikat shkencore për nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në kërkim;
- Anëtarët e Akademisë së të Rinjve ftohen të marrin pjesë si të ftuar në mbledhjen vjetore të Asamblesë dhe në mbledhje të tjera, për të cilat vendos Kryesia rast pas rasti;
- Anëtarët e Akademisë së të Rinjve që fitojnë mbështetje për një projekt, botim apo kërkim në terren/arkiva kanë të drejtën e një kontrate me detyrime të përcaktuara.

6. Të drejta dhe detyrime të anëtarësisë

1. Anëtari i Akademisë së të Rinjve ka këto të drejta:

- Të marrë pjesë si organizues, drejtues, referues, në konferenca, diskutime e seminare të Akademisë së të Rinjve;
- Të shprehë mendim për politikat e kërkimit shkencor dhe të zhvillimit të arsimit të lartë, të reformave dhe ndryshimeve strukturore në proces;
- Të informohet paraprakisht për programin vjetor, marrëveshje e protokolle bashkëpunimi që nxisin ndërveprimin mes të rinjve dhe të propozojë pjesëmarrje e bashkëpunim;
- Të marrë pjesë në eventet e organizuara nga Akademia e Shkencave;
- Të përdorë informacionin shkencor të administruar nga Akademia e Shkencave; rrjetet e komunikimit dhe bazat e të dhënave shkencore.

2. Detyrat kryesore të anëtarit të Akademisë së të Rinjve janë:

- Të njohë dhe respektojë ligjin dhe Statutin e Akademisë së Shkencave; të respektojë dispozitat ligjore-akademike në fuqi;
- Të njohë dhe respektojë këtë *kartë themelore të Akademisë së të Rinjve* dhe rregulloret e tjera të saj;
- Të njohë dhe respektojë *kodin europian për sjelljen në kërkimin shkencor*, miratuar nga ALLEA;
- Të mbrojë e nderojë emrin e studiuesit të rinj dhe të rrisë prestigjin e tij;

7. Ndryshimi i *kartës themelore*

Kjo kartë ndryshohet me propozim të Asamblesë së Akademisë së të Rinjve e miratim të Kryesisë së ASH-së për amendamente të veçanta. Për ndryshime thelbësore ato i paraqiten Asamblesë. Ndryshimet në Kartën Europiane për akademitë e të rinjve që miratohen nga ALLEA paraqiten menjëherë si të tilla në tekstin e saj.

8. Hyrja në fuqi

Kjo kartë hyn në fuqi me miratimin nga Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.